



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 253, Datë 21.12.2021

MBI

**MBI ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 22 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr. 687 datë 22.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, e ndryshuar me VKM-në nr. 396, datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi” si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 156/9 prot., datë 17.12.2021 e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022”,

Konstatoi se:

- Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i rishikuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”.
- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë, çmimi mesatar për periudhën Janar - Nëntor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2021, rezulton në vlerën **101.40 Euro/MWh**.
- Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, për periudhën Janar - Nëntor, rezulton se kursi mesatar i këmbimit të jetë **122.61 Lekë/Euro**.
- Nga përlllogaritjet mbi të dhënat paraprake rezulton se çmimi vjetor i blerjes do të jetë

$$P_u = 101.4 / 1000 * 1.2 * 122.61 = 14.92 \text{ Lekë/kWh}$$

- Kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, përcaktohen sipas germave “ç” dhe “d” të pikës 2 të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017 e ndryshuar, ku kufiri minimal është çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim dysHEME) dhe ai maksimal është 15% më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim tavan).
- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 13 datë 16.02.2016 ka vendosur që, Tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, do të jetë 7.448 lekë/kW.
- Bazuar në përlllogaritjet mbi të dhënat paraprake, gjendemi në kushtet kur çmimi maksimal i lejuar mbështetur në përcaktimet e VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, e ndryshuar, është 15% më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues:

$$7.448 * (1 + 15\%) = 8.5652 \text{ Lekë/kWh}$$

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022 të jetë 8.5652 Lekë/kWh.
2. Me publikimin e raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2021 si dhe Publikimin e Raportit vjetor të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të Bursës Hungareze të Energjisë, në rast se do të ketë ndryshime që do të çojnë në ndryshimin e Çmimit vjetor të blerjes së energjisë, ERE do të korrigjojë çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike i cili do t’u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2022.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.